



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

KOMUNA E KAMENICËS
Zyra e Kryetarit
Nr.02/dt.05/12/2024
Kamenicë.

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02	Nr. Br. 37558
Nr. i faq. 1	Data: 05/12
Br. str.	Datum: 2024
KAMENICË/A	

THIRRJE

Për.....nga.....

Kryetari i Komunës, konform dispozitave në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, caktoi mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi e cila do të mbahet më **11/12/2024**, më fillim në ora **14.00h**.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Mbrojtja e qytetareve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare si mbrojtja dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në integrimin e viktimës;
3. Të ndryshme

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Ndërtesën e Administratës Komunale në Kamenicë.





PROCESVERBAL

I përpiluar më datë 21/11/2024, me fillim në ora 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal në Kamenicë. Prezent janë Kryetari i Komunës z. Kadri Rahimaj me anëtarë të KKSBB-së dhe përfaqësues të KFOR-it, e OSBE-së .

Rend dite:

6. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
7. Paraqitja e gjendjes aktuale në komunë. Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Kamenicës;
8. Sanimi i rrugëve-probleme me infrastrukturën rrugore në disa pjesë me (dëmtime, gropa në rrugët e qytetit dhe në fshatra) si dhe ndriçimi publik ;
9. Funksionimi i kamerave në qytet;
10. Të ndryshme

Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi z. Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës i cili përshëndeti të pranishmit dhe hodhi në votim rendit e ditës, rendi i ditës miratohet nga të gjithë të pranishmit.

Pika I

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës; hedh në votim procesverbalin i cili miratohet nga të pranishmit.

Pika II

Paraqitja e gjendjes aktuale në komunë. Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Kamenicës.

Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës, kur jemi te siguria nuk ka arritur ndonjë raport për gjendjen e sigurisë në një sferë të caktuar gjatë kësaj kohe, kemi disa ndalesa në prerje të pyjeve.

Nazif Hajrizi, Komandant i Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit, kemi një bashkëpunim të mirë me inspektoret e pyjeve, e kur hasim në këso probleme ne si polici veprojmë menjherë.

Sherafedin Vranja, përfaqësues i OJQ-ve, një depo e drunjëve që janë krijuar afër objektit komunal dhe rrugës kryesore nuk po i japim pamje të mirë qytetit.

Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës, është e vërtetë, këta drunj duhet të largohen sa më shpejt.

Pika III

Sanimi i rrugëve-probleme me infrastrukturën rrugore në disa pjesë me (dëmtime, gropa në rrugët e qytetit dhe fshatrave) si dhe ndriçimi publik.

Burim Krasniqi, përfaqësues nga DSHPAIE, gjendja me ndriçim publik është e mirë nuk kemi informata që ndonjë gropë është mbyllur i kemi afro 3400 trupa ndriçuese.

Hyrmete Morina përfaqësues e Handikosit, në disa rrugë personat me aftësi të kufizuara nuk kanë qasje në trotuare dhe të keni parasysh kur jeni në fazën e zgjerimit që edhe trotuaret të kenë qasje për personat me aftësi të kufizuar.

Sherafedin Vranja, përfaqësues i OJQ-ve, një gropë që është afër QPS-së, kur jemi te ridizajnimi i qytetit kjo gropë duhet të sanohet.

Adem Hashani KLSP, kërkoj që rruga "Mali" të ndriçohet me trupa ndriçuese.

Nazif Hajrizi, komandant i stacionit policor për mbikëqyrje të kufirit, në rrugën "Kukësi" në lagjen Çamëria nuk funksionon ndriçimi publik, a ka mundësi të intervenohet apo vazhdon të mbetet kështu.

Pika IV

Funksionimi i kamerave në qytet;

Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës, si komunë kemi investuar në kamera të sigurisë në vlerë prej 40.000€ të cilat janë në menaxhimin e Stacionit Policor të Kamenicës. Po synojmë që edhe hapësirat publike dhe vendet kryqë të mbikëqyren me kamera.


Pika V

Të ndryshme;

Hyrmete Morina përfaqësuese e HANDIKos-it, në si HANDIKos në Kamenicë nuk kemi objekt dhe nuk po mundemi të operojmë, nuk kemi zyre dhe po kemi vështërsi të mëdha.

Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës, i kemi 30 OJQ që veprojnë në Kamenicë e të cilat ndihmohen nga Komuna, si zgjidhje i kemi ofruar dhe i kemi përkrah, është pagesa e qerasë, zgjidhje tjetër është të posta e Kosovës dhe tjerat tek palestra dhe shtëpia e kulturës si institucione po mundohemi të bëjmë zgjidhjen e duhur.

Procesmbajtës:


Fisnik Kastrati

Kryetari i Komunës

Kadri RAHIMAJ